

Sundimi i Ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

— dokument tremujor —

korrik-shtator 2024



Instituti
për
politikë
evropiane.
Shkup



Ky projekt finansohet nga Bashkimi Evropian

Sundimi i ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE

Dokument tremujor korrik-shtator 2024

Botues:

Instituti për politikë evropiane - Shkup

Për botuesin:

Dr. Simonida Kacarska

Redaktorët:

Dr. Simonida Kacarska

Autorë:

Angela Delevska

Beba Zhagar

Juljana Karai

Cvetanka Aleksandroska

Përkthim nga gjuha angleze në gjuhën shqipe:


Blerina Starova Zlatku

Dizajn gra ik:

Relativ

Shkup, 2024

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit “Ndërtojmë urë për një të ardhme të përbashkët: Sundimi i së drejtës në drejtim të aderimit në BE”, i inancuar nga Bashkimi Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e autorëve dhe assesi nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet dhe pikëpamjet e Bashkimit Evropian.



Ky dokument paraqet zhvillimet kryesore në lidhje me sundimin e ligjit në kontekst të anëtarësimit në BE në Maqedoninë e Veriut për periudhën korrik – shtator 2024. Ai përfshin monitorimin e themeleve të anëtarësimit në BE, duke përfshirë zhvillimet kryesore në funksionimin e institucioneve demokratike, reformën e administratës publike dhe kapitullin 23: Gjyqësori dhe të drejtat themelore.

Zhvillimet kryesore

- » Në fund të shtatorit, Kuvendi miratoi ndryshimet në ligjin për vetëqeverisjen lokale.
- » Bashkimi Evropian (BE) e ndau Maqedoninë e Veriut nga Shqipëria në rrugën e saj të anëtarësimit në BE, me Shqipërinë gati për të hapur grupin e saj të parë të negociatave më 15 tetor.
- » Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit (KSHPK) paraqiti një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese duke kundërshtuar kërkesën e Balancuesit që kandidatët për punë administrative të deklarojnë përkatësinë etnike, duke çuar në ngrirje të përkohshme të masës; më pas, më 30 shtator 2024, Ministria e Administratës Publike udhëzoi institucionet të anulojnë njoftimet e punës që specifikojnë përkatësinë etnike si kriter, pas vendimit të Gjykatës Kushtetuese Nr. 90/2024.
- » Më 20 gusht 2024, Qeveria dorëzoi në Kuvend propozim-ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik. Ky ligj detyron që të gjitha institucionet publike të publikojnë dhe përditësojnë rregullisht të dhënat e krijuara në punën e tyre të përditshme, të sigurojnë funksionalitetin e faqes së internetit dhe lidhjen me katalogun qendror të të dhënave dhe të caktojnë një person kontakti për rregullime teknike dhe publikimin e të dhënave.
- » Më 14 gusht 2024, Kuvendi themeloi Komisionin e Përkohshëm për monitorimin e përfaqësimit të barabartë të të gjitha komuniteteve brenda organeve të qeverisjes shtetërore dhe institucioneve publike në të gjitha nivelet.
- » Në gusht, pas marrëveshjeve të pranimit të fajësisë, Gjykata Themelore Penale e Shkupit dënoi një gjyqtar të Gjykatës Supreme me tre vjet burg për ndikim të paligjshëm dhe një anëtar të Këshillit të Prokurorëve Publikë me një mandat të pezulluar një vjeçar për ryshfet, duke çuar në dorëheqjet e tyre dhe kufizime profesionale.
- » Pas thirrjes së Kryeministrit për reforma në gjyqësor, një takim i 20 gushtit i udhëhequr nga Kryetari i Këshillit Gjyqësor përfundoi me ripohimin e Kryeministrit për mbështetjen për shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe të Prokurorëve, duke mbetur i hapur ndaj propozimeve alternative për të rikthyer besimin e publikut.
- » Pas vendimit të Gjykatës së Lartë Administrative se Akademia për Gjyqtarë dhe Prokurorë Publikë shkeli ligjet zgjedhore dhe antikorrupsion në pranimin e praktikantëve, drejtori i saj dha dorëheqjen më 12 korrik. Zëvendës drejtori mori drejtimin e përkohshëm dhe Bordi Drejtues kërkoi një mendim nga Qeveria dhe Ministria e Financave nëse do të vazhdohet me pranimet e praktikantëve ndërsa fillon një kërkim për një drejtor të ri.
- » KSHPK-ja lëshoi raporte të veçanta për financimin e zgjedhjeve presidenciale dhe parlamentare të vitit 2024, duke zbuluar dobësi të shumta, rreziqe korrupsioni dhe sfida financiare në lidhje me financimin e fushatës.
- » Sipas Indeksit Botëror të Lirisë së Shtypit 2024 nga Gazetarë pa Kufij, Maqedonia e Veriut u përmirësua me dy vende, duke u renditur e 36-ta nga 180 vende, pavarësisht çështjeve të dezinformimit, mungesës së profesionalizmit, financimit të kufizuar të shtetit dhe sulmeve verbale kundër punonjësve të medias.
- » Viti shkollor 2024-2025 filloi me sfida të konsiderueshme për nxënësit me aftësi të kufizuara, duke përfshirë mungesën e asistentëve arsimorë dhe mjete të papërshtatshme në klasë, siç janë tabelat inteligjente dhe materialet e printuara. Këto sfida bënë që Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi (KPMĐ) të fillojë procedurat kundër Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH) për diskriminim indirekt në qasjen në arsim fillor.
- » Në fillim të gushtit, Gjykata Themelore Civile Shkup vendosi që Qeveria, MASH, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, Ministria e Shëndetësisë, Inspektorati Shtetëror i Arsimit dhe komunat e Manastirit dhe Shtipit kishin bërë diskriminim përmes ndarjes së fëmijëve romë në arsim.



Lista e shkurtesave

PTHP	Zyra e Prokurorisë Themelore Publike
PTHPNKOK	Prokuroria Themelore Publike për Ndjekjen e Krimit të Organizuar dhe Korrupsionit
QMN	Qendra për menaxhim me ndryshimet
KPMD	Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi
DCAF	Qendra e Gjenevës për Qeverisjen e Sektorit të Sigurisë
BDI	Bashkimi Demokratik për Integrim
BE	Bashkimi Evropian
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
MBN	Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
IPA	Instrumenti për Ndihmën e Para-anëtarësimit
LOPOASH	Ligji për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore
MASH	Ministria e Arsimit dhe e Shkencës
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme
MKD	Denari i Maqedonisë
Deputet	Deputet
MAP	Ministria e Administratës Publike
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
RAP	Reforma e Administratës Publike
ReSPA	Shkolla Rajonale e Administratës Publike
RMV	Republika e Maqedonisë së Veriut
ESHR	Enti Shtetëror për Revizion
KSHPK	Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit
LSDM	Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë
KB	Kombet e Bashkuara
VMRO-DPMNE	Organizata e brendshme revolucionare maqedonase – Partia Demokratike për Unitetin Kombëtar Maqedonas



Përmbajtje

Funksionimi i Institucioneve Demokratike	6
Zgjedhjet	7
Kuvendi	8
Qeverisja	9
Shoqëria Civile	11
Mbikëqyrja Civile e Sektorit të Sigurisë/Inteligjencës	12
Reforma e Administratës Publike	13
 Kapitulli 23	 16
Funksionimi i Gjyqësorit	17
Dokumente strategjike	17
Organet menaxhuese	17
Pavarësia dhe pëanshmëria	17
Llogaridhënia	18
Profesionalizmi dhe kompetenca	20
Cilësia e Drejtësisë	20
Efikasiteti	21
 Lufta Kundër Korrupsionit	22
Komisioni Shtetëror për Parandalimin e Korrupsionit	22
Prokuroria Publike	23
 Të drejtat themelore	24
Tortura, trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese	24
Objektet e burgut dhe paraburgimit	24
Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe fesë	25
Liria e Shprehjes	25
Grupet e cënueshme dhe parimi i mosdiskriminimit	26
Romët	27

Funksionimi i Institucioneve Demokratike



Zgjedhjet

Në fund të shtatorit, Kuvendi miratoi ndryshimet në Ligjin për Vetëqeverisjen Lokale me 83 vota pro (përfshirë shumicën e Badinterit) dhe 17 kundër. Këto ndryshime lejojnë që kryetarët e komunave në Aerodrom, Saraj dhe Gostivar të qëndrojnë në detyrë deri në zgjedhjet e ardhshme të rregullta lokale në tetor 2025. Ndryshimet u prezantuan për të shmangur mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme, pasi kryetarët e mëparshëm të komunave ishin bërë deputetë ose ministra. Mbështetësit e ndryshimeve të ligjit, përfshirë Fronti Evropian, argumentuan se ky ndryshim do të parandalonte shpenzimet e panevojshme dhe do t'i kursente qytetarët nga shqetësimi i zgjedhjeve vetëm një vit para zgjedhjeve të planifikuara lokale. VMRO-DPMNE e përshkroi masën si kalimtare, që synon të sigurojë vazhdimësi në qeverisjen lokale dhe të shmangë ndërprerjet deri në zgjedhjet e rregullta.¹ Megjithatë, deputetët nga partia opozitare LSDM kundërshtuan ndryshimet, duke argumentuar se ato shkelin të drejtën e qytetarëve për të zgjedhur udhëheqësit e tyre.²

1 'Nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme lokale, Saraj, Aerodrom dhe Gostivar do të menaxhohen nga kryetarët aktual të komunave (Нема да има предвремени локални избори, со Сарај, Аеродром и Гостивар ќе раководат в.д градоначалници)', Nova Makedonija, 24 shtator 2024, <https://novamakedonija.com.mk/makedonija/nema-da-ima-predvremani-lokalni-izbori-so-saraj-aerodrom-i-gostivar-kje-rakovodat-v-d-gradonachalnici/>.

2 'Kuvendi vendosi: Nuk do të ketë zgjedhje të parakohshme lokale në Gostivar, Saraj dhe Aerodrom (Собранието одлучи: Нема предвремени локални избори во Гостивар, Сарај и Аеродром)', Kanal 5, 24 shtator 2024, <https://kanal5.com.mk/sobranieto-odluchi-nema-predvremani-lokalni-izbori-vo-gostivar-saraj-i-aerodrom/a660768>.

Kuvendi

Më 5 korrik, në seancën e 9-të të Kuvendit, u zgjodh Sekretari i ri i Përgjithshëm dhe Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm i Kuvendit.³

Më 11 korrik, Kuvendi i Maqedonisë së Veriut shënoi Ditën e Përkujtimit të Gjenocidit në Srebrenicë, duke nënvizuar rëndësinë e edukimit të brezave të ardhshëm mbi rreziqet e urrejtjes dhe paragjykitimit dhe duke riafirmuar angazhimin e Maqedonisë së Veriut për të mbështetur qëndrimin e Kombeve të Bashkuara (KB) për Srebrenicën dhe ruajtjen e kujtimit për të.⁴ Megjithatë, polemikat u ngritën pasi një fotografi që tregonte një lutje të mbajtur në Kuvend gjatë përkujtimit ngjalli reagime nga partitë politike. Si partitë e opozitës ashtu edhe ato të koalicionit qeverisës argumentuan se ritet fetare në institucionet shtetërore shkelnin kushtetutën laike të vendit, me Levicën që njoftoi planet për të paraqitur një interpellancë kundër Kryetarit të Kuvendit.⁵ Pjesëmarrësit në këtë ngjarje e mbrojtën aktin, duke sqaruar se lutja ishte një zgjedhje personale dhe jo një ritual zyrtar fetar.⁶

Në fund të korrikit, Kryetari i Kuvendit raportoi se deputetët e BDI-së morën mesazhe kërcënuese anonime. Ai dënoi të gjitha kërcënimet dhe u kërkoi institucioneve përkatëse të hetojnë menjëherë incidentet.⁷

Më 10 shtator, në Kuvend u krijua Klubi Parlamentar për Çështjet dhe Politikat Rinore me 21 deputetë, kryesisht nën 35 vjeç. Klubi synon të përmirësojë statusin e të rinjve dhe të rivendosë besimin në institucione, duke punuar me organizatat rinore dhe grupet joformale.⁸ Seanca e tij e parë u mbajt më 19 shtator, duke u përqëndruar në politikat rinore dhe Ligjin për Pjesëmarrjen e të Rinjve.⁹

Në fund të shtatorit, Kryetari i Kuvendit mbajti një konferencë me gazetarët parlamentarë, duke i informuar ata se që nga fillimi i mandatit aktual parlamentar, janë mbajtur 15 seanca plenare. U shpallën gjithashtu plane për të rritur frekuencën e seancave plenare.¹⁰

3 'Marina Dimovska u zgjodh si Sekretare e Përgjithshme e Kuvendit (Марина Димовска избрана за генерална секретарка на Собранието)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 korrik 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-marina-dimovska-izbrana-za-generalna-sekretarka-na-sobranieto.nspk>.

4 'Kujtimi i gjenocidit në Srebrenicë në Kuvendin e Maqedonisë së Veriut (Сеќавање на геноцидот во Сребреница во Собранието на РСМ)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-sekavane-na-genocidot-vo-srebrenica-vo-sobranieto-na-rsm.nspk>.

5 'Reagimi i partive në lutjen në Kuvend: Ky është një shtet laik (Реакција на партиите за молитвата во Парламентот: Ова е секуларна држава)', A1on, 12 korrik 2024, <https://a1on.mk/macedonia/po-levica-reakcija-i-na-drugite-partii-za-molitvata-vo-parlamentot-ova-e-sekularna-drzhava/>.

6 'Një gjest njerëzor nuk kërcënon laicitetin e shtetit, thonë nga "Vlen" për lutjen në Kuvend (Еден човечки гест не ја загрозува секуларноста на државата, велат од „Вреди“ за молитвата во Собранието)', 360 Stepeni, 13 korrik 2024, <https://360stepeni.mk/eden-chovechki-gest-ne-ja-zagrozuvata-sekularnosta-na-drzhavata-velat-od-vredi-za-molitvata-vo-sobranieto/>.

7 'Njoftim për publikun (Соопштение до јавноста)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 27 korrik 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-soopshenie-do-javnosta.nspk>.

8 'Klubi për Çështje dhe Politika Rinore u krijua në Kuvendin e RMV-së (Конституиран Клубот за младински прашања и политики во Собранието на РСМ)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 10 shtator 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-konstituiran-klubot-za-mladinski-prasana-i-politiki-vo-sobranieto-na-rsm.nspk>.

9 'Klubi për Çështje dhe Politika Rinore mbetet partner për të gjitha organizatat rinore (Клубот за младински прашања и политики останува партнер за сите младински организации)', 19 shtator 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-klubot-za-mladinski-prasana-i-politiki-ostanuva-partner-za-site-mladinski-organizacii.nspk>.

10 'Briefing i shtatorit nga kryetari Gashi me gazetarët parlamentarë (Септемврски брифинг на претседателот Гаши со собраниските известувачи)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 26 shtator 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-septemvrski-brifing-na-pretседателot-gashi-so-sobraniskite-izvestuvaci.nspk>.

Qeverisja

Sipas raportit të revizorit shtetëror, Maqedonia e Veriut renditet e pesta në Evropë për “ikjen e trurit”, duke humbur mesatarisht 2,500 profesionistë me arsim të lartë çdo vit midis 2013 dhe 2021. Kjo ka rezultuar në mbi 700 milionë euro dëme gjatë tetë viteve të fundit dhe një ndikim negativ prej 8.34% në PBB-në e vendit. Raporti thekson masat joefektive të qeverisë, duke përfshirë standardet joadekuate të studentëve, mundësitë e dobëta të punësimit dhe një strategji të gabuar të bursave që i dërgon studentët jashtë vendit pa siguruar kthimin e tyre. Ai gjithashtu vëren se strategjia kombëtare për të trajtuar ikjen e trurit (2013–2020) nuk është publikuar dhe planet kryesore të veprimit të qeverisë janë zbatuar dobët.¹¹ Për më tepër, vlerësimet e KB-së tregojnë se popullsia e Maqedonisë së Veriut parashikohet të bjerë nga 1,836,000 në 1,519,000 deri në vitin 2050, duke përfaqësuar një rënie prej 17.3%.¹²

Në fillim të korrikut, Kryeministri i Maqedonisë së Veriut njoftoi një marrëveshje kredie prej 500 milionë eurosh me Hungarinë, e cila u arrit gjatë një takimi të nivelit të lartë të NATO-s me Kryeministrin hungarez. Kredia, me një periudhë mospagimi trevjeçare dhe një plan shlyerjeje 12-vjeçar, ka për qëllim mbështetjen e ekonomisë së vendit dhe financimin e investimeve kapitale komunale. Marrëveshja përfshin gjithashtu dispozita për ndihmën e ardhshme financiare nga Hungaria nëse është e nevojshme.¹³ Kredia u autorizua në Kuvend më 17 shtator, pavarësisht shqetësimeve të ngritura nga opozita për transparencën e kredisë dhe paralajmërimeve për rritjen e borxhit publik.¹⁴

Më 17 korrik, Ministria e Financave prezantoi buxhetin e ribalancuar, duke theksuar sfidat e trashëguara nga qeveria e mëparshme dhe përmirësimet e parashikuara ekonomike. Qeveria, e udhëhequr nga VMRO-DPMNE, kritikoi qeverinë e mëparshme për planifikim joadekuat dhe shpenzime të tepërta, duke vënë në dukje se parashikimet fillestare të rritjes ekonomike tani konsideroheshin të paarrtshme. Ribalancimi tregon një deficit buxhetor të parashikuar prej 44 miliardë denarë, me alokime të konsiderueshme për paga, pensione dhe programe të tjera sociale. Kritikët, përfshirë partinë tani në opozitë LSDM, pretendojnë se qeveria po zhvendos fajin ndërsa nuk arrin të trajtojë kërkesat e sindikatës për rritje të pagës minimale.¹⁵ Më 12 gusht, Kuvendi miratoi ribalancimin me 67 vota pro. Buxheti i rishikuar parashikon rritje të PBB-së prej 2.1%, inflacion në 3.5% dhe deficit buxhetor prej 4.9%, me të ardhura totale të vlerësuara në 318.2 miliardë denarë dhe shpenzime në 362.8 miliardë denarë.¹⁶

Në gusht, Kryeministri pretendoi se rivalët politikë u përpoqën të shkaktonin trazira dhe tensione etnike. Ai akuzoi në mënyrë specifike BDI-në, partinë më të madhe etnike shqiptare, për komplot për të minuar harmoninë ndëretnike për të mbrojtur interesat e tyre. BDI, duke pretenduar se përfaqëson popullsinë më të madhe etnike shqiptare, shprehu zhgënjimin për përjashtimin nga qeveria në favor të një rivali etnik-shqiptar. Koalicioni VLEN mori më pak vota në zgjedhjet parlamentare. Ata e përshkruan këtë përjashtim si një akt të “injorimit të vullnetit të shqiptarëve” dhe shpallën protesta të mundshme këtë vjeshtë, duke ngritur shqetësime për stabilitetin në vend. Megjithatë, BDI mohoi akuzat e Kryeministrit, duke i etiketuar ato si të pavërteta dhe një devijim nga mangësitë e qeverisë.¹⁷

11 ‘Maqedonia renditet e pesta në Evropë për sa i përket ikjes së trurit (Македонија на петто место во Европа по одлив на мозоци)’, Sitel, 2 korrik 2024, <https://sitel.com.mk/makedonija-na-petto-mesto-vo-evropa-po-odliv-na-mozoci>.

12 ‘Maqedonia do të ketë 300,000 banorë më pak deri në vitin 2050 - Vlerësimi i Kombeve të Bashkuara (Македонија ќе има 300.000 жители помалку до 2050 година - Проценка на Обединетите Нации)’, Telma, 23 gusht 2024, <https://telma.com.mk/2024/08/23/makedonija-ke-ima-300-000-zhiteli-pomalku-do-2050-godina-proczenka-na-obedinetite-nacii/>.

13 ‘Mickoski ra dakord me Orban për një kredi hungareze prej 500 milionë eurosh (Мицкоски со Орбан договорил унгарски кредит од 500 милиони евра)’, Radio Evropa e Lirë, 11 korrik 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/33032671.html>.

14 ‘Kuvendi miratoi ligjin për një hua prej gjysmë miliardë eurosh nga Hungaria (Собранието го изгласа законот за заем од половина милијарда евра од Унгарија)’, Meta.Mk, 17 shtator 2024, <https://meta.mk/sobranieto-go-izglasa-zakonot-za-zaem-od-polovina-milijarda-evra-od-ungarija/>.

15 ‘Ribalancimi i buxhetit – Shpëtimi nga vdekja klinike ose kërkimi i një alibie (Ребаланс на буџетот – Спас од клиничка смрт или барање алиби)’, Radio Evropa e Lirë, 17 korrik 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/budjet-plati-dolg-/33039965.html>.

16 ‘Kuvendi miratoi ribalancimin e buxhetit për vitin 2024 (Собранието го изгласа ребалансот на буџетот за 2024)’, VOA, 12 gusht 2024, <https://mk.voanews.com/a/sobranieto-go-izglasa-rebalansot-na-budjetot-za-2024/7739508.html>.

17 ‘SHBA mban një sy në Maqedoninë e Veriut mes frikës së “destabilizimit”’, Balkan Insight, 20 gusht 2024, <https://balkaninsight.com/2024/08/20/us-keeps-an-eye-on-north-macedonia-amid-destabilisation-fears/>.

Lidhur me mosmarrëveshjen e vazhdueshme me Bullgarinë, Ministri i Punëve të Jashtme dhe Tregtisë së Jashtme deklaroi në gusht se ai parashikon formimin e një qeverie të re në Bullgari, e cila do të lejonte një dialog të zgjeruar për çështje të ndryshme, duke vënë në dukje vitin e ardhshëm zgjedhor në Bullgari si një katalizator të mundshëm për bisedime të rinovuara.¹⁸ Përveç kësaj, ai argumentoi për vonimin e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese për të garantuar sigurinë kundër çështjeve të mundshme me Bullgarinë dhe theksoi nevojën për reciprocitet në lidhje me të drejtat e pakicave.¹⁹ Ministri i Çështjeve Evropiane shprehu pikëpamje të ngjashme për vonesën e zbatimit të ndryshimeve kushtetuese si një zgjidhje e mundshme,²⁰ duke theksuar gjithashtu se krijimi i një klime të favorshme politike dhe mbështetja publike është thelbësore për ndryshimet kushtetuese.²¹ Në fund të gushtit, Kryeministri njoftoi ndryshime në përbërjen e Komisionit të Përbashkët Multidisiplinar të Ekspertëve për Çështjet Historike dhe Arsimore midis Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë, duke deklaruar se anëtarët e tij kishin dështuar të mbronin interesat kombëtare.²² Përbërja e re e Komisionit u caktua më 10 shtator, me anëtarë që përfshinin historianë nga institute të ndryshme. Kryetari i ri i Komisionit kishte dhënë më parë dorëheqjen në vitin 2021, duke përmendur presionin dhe ndërhyrjen politike.²³ Pas vendimit, ish-anëtarët e Komisionit Historik kritikuan keqpërdorimin politik të punës së Komisionit nga autoritetet maqedonase dhe bullgare. Ata akuzuan politikanët dhe intelektualët për prioritizimin e qëllimeve politike dhe partiake mbi parimet akademike, veçanërisht në lidhje me identitetin kombëtar dhe historiografinë. Ata kërkuan ndryshime në metodologjinë e Komisionit dhe përfshirjen e ekspertëve ndërkombëtarë për të zvogëluar ndërhyrjen politike.²⁴

Tensionet diplomatike u ngritën midis Maqedonisë së Veriut dhe Bullgarisë pas një takimi midis dy Presidentëve në Sofje në mes të shtatorit, ku flamuri maqedonas mungonte në fotografitë zyrtare. Kjo bëri që Maqedonia e Veriut të thërriste ambasadorin bullgar për të lëshuar një notë protesti por ajo nuk u dorëzua. Bullgaria e minimizoi incidentin, duke deklaruar se nuk ishte një vizitë zyrtare, ndërsa Maqedonia e Veriut e kritikoi mosveprimin si cenim të dinjitetit të saj kombëtar.²⁵

Në fund të shtatorit, BE e ndau Maqedoninë e Veriut nga Shqipëria në rrugën e saj drejt anëtarësimit në BE, me Shqipërinë gati për të hapur grupin e saj të parë të negociatave më 15 tetor.²⁶ Pas këtij vendimi, Kryeministri përsëriti se ndërsa qeveria është e gatshme të negociojë, ajo kërkon që çdo ndryshim kushtetues të aktivizohet vetëm pasi Bullgaria të ratifikojë protokollin e anëtarësimit të Maqedonisë së Veriut në BE. Ai shprehu zhgënjim për standardet e dyfishta të perceptuara dhe i kërkoi BE-së të pranojë propozimet e Maqedonisë së Veriut për negociatë.²⁷

18 'Mucunski: Pres një qeveri politike në Bullgari me të cilën mund të hapim dialog në disa nivele (Муцунски: Очекувам политичка влада во Бугарија со која ќе можеме да отвориме дијалог на повеќе нивоа)', 360 Stepeni, 16 gusht 2024, <https://360stepeni.mk/mutsunski-ochekuvam-politichka-vlada-vo-bugarija-so-koja-ke-mozheme-da-otvorime-dijalog-na-poveke-nivoa/>.

19 'Mucunski: Efekti i vonuar i ndryshimeve kushtetuese është një qasje racionale', Sloboden Pечат, 19 gusht 2024, <https://www.slobodenpechat.mk/en/mucunski-odlozhenoto-dejstvo-na-ustavnite-izmeni-e-racionalen-pristap/>.

20 'Murtezani: Ndryshimet kushtetuese me efekt të vonuar do të ishin një garanci se nuk do të ketë bllokada të reja, korniza e negociatave nuk ndryshon (Муртезани: Уставни измени со одложено дејство би биле гаранција дека ќе нема нови блокади, преговарачката рамка не се менува)', Libertas, 22 gusht 2024, <https://libertas.mk/murtezani-ustavni-izmeni-so-odlozhenode-stvo-bi-bile-garanci-a-deka-e-nema-novi-blokadi-pregovarachkata-ramka-ne-se-menuva/>.

21 'Për ndryshimet kushtetuese, nevojitet një klimë e përshtatshme politike - një takim midis Murtezanit dhe Varhej (За уставни измени треба соодветна политичка клима - средба на Муртезани и Вархеј)', Telma, 4 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/04/za-ustavni-izmeni-treba-soodvetna-politichka-klima-sredba-na-murtezani-i-varheji/>.

22 'Mickoski njoftoi ndryshime të personelit në komisionin historik me Bullgarinë: Ai aktualisht nuk i mbrojt interesat kombëtare (Мицкоски најави кадровски промени во историската комисија со Бугарија: Актуелната не ги шитеше националните интереси)', 360 Stepeni, 26 gusht 2024, <https://360stepeni.mk/mitskoski-najavi-kadrovski-promeni-vo-istoriskata-komisija-so-bugarija-aktuelnata-ne-gi-shiteshe-natsionalnite-interesi/>.

23 'Qeveria ka zgjedhur përbërjen e re të Komisionit për Çështje Historike me Bullgarinë - Ванчо Gjorgiev është emëruar si Kryetar (Владата го избра новиот состав на Комисијата за историски прашања со Бугарија - За претседател е назначен Ванчо Ѓорѓиев)', 360 Stepeni, 10 shtator 2024, <https://360stepeni.mk/vladata-go-izbra-noviot-sostav-na-komisijata-za-istoriski-prashana-so-bugarija-za-pretседател-e-naznachen-vancho-gorgiev/>.

24 'Komisioni historik u keqpërdor për qëllime politike dhe partiake në të dy vendet, thonë ish-anëtarët e ekipit maqedonas (Историската комисија беше злоупотребена за политички и партиски цели во двете земји, велат поранешните членови од македонскиот тим)', 360 Stepeni, 12 shtator 2024, <https://360stepeni.mk/istoriskata-komisija-beshe-zloupotrebenaza-politichki-i-partiski-tseli-vo-dvete-zemji-velat-poranesnite-chlenovi-od-makedonskiot-tim/>.

25 'Shkup dhe Sofje - Nga diplomacia kulturore në notë protesti (Скопје и Софија - Од културна дипломатија до протестна нота)', Radio Evropa e Lirë, 16 shtator 2024, <https://www.slobodnaevropa.mk/a/bugarija-protest-zname/33122018.html>.

26 'BE ndau Maqedoninë dhe Shqipërinë në rrugën drejt BE-së (EY ги razdeli Македонија и Албанија на патот кон EY)', Telma, 26 shtator 2024, <https://telma.com.mk/2024/09/26/eu-gi-razdeli-makedonija-i-albanija-na-patot-kon-eu/>.

27 'Një mesazh i keq po u dërgohet qytetarëve të Maqedonisë, ata vetëm po na torturojnë - Mickoski për ndarjen e Maqedonisë së Veriut dhe Shqipërisë nga rruga drejt BE-së (Се испраќа лоша порака кон македонските граѓани, само се изживуваат врз нас - Мицкоски за одвојувањето на С.Македонија и Албанија од патот кон EY)', 360 Stepeni, 26 shtator 2024, <https://360stepeni.mk/se-ispraka-losha-poraka-kon-makedonskite-gragani-samo-se-izhivuvaat-vrz-nas-mitskoski-za-odvojuvaneto-na-s-makedonija-i-albanija-od-patot-kon-eu/>.

Shoqëria Civile

Më 25 shtator, u mbajt “Dialogu midis Qeverisë dhe Shoqërisë Civile”, me fokus në sundimin e ligjit, qeverisjen e mirë dhe luftën kundër korrupsionit. Kryeministri shprehu besimin në angazhimin e Qeverisë për trajtimin e këtyre çështjeve me mbështetjen e shoqërisë civile dhe partnerëve ndërkombëtarë.²⁸ Në të njëjtën kohë, Ministri i Drejtësisë nënvizoi hapjen e qeverisë për bashkëpunim me shoqërinë civile, duke theksuar përfshirjen e tyre në reformat ligjore dhe përpjekjet antikorruption si thelbësore për arritjen e progresit kuptimplotë.²⁹

28 ‘Mickoski: Lufta kundër krimit dhe korrupsionit duhet të jetë vendimtare, jam i bindur se me IRI dhe OJQ-të do të arrijmë shumë (Мицкоски: Борбата со криминалот и корупцијата мора да биде одлучна, убеден сум дека со ИРИ и невладините ќе направиме многу)’, 360 Stepeni, 25 shtator 2024, <https://360stepeni.mk/mitskoski-borbata-so-kriminalot-i-korupsijata-mora-da-bide-odluchna-ubeden-sum-deka-so-iri-i-nevladinite-ke-napравime-mnogu/>.

29 ‘Fillkov: Qeveria dhe shoqëria civile do të luftojnë krimin dhe korrupsionin së bashku (Филков: Владата и граѓанскиот сектор заедно ќе се борат против криминалот и корупцијата)’, Fokus, 25 shtator 2024, <https://fokus.mk/filkov-vladata-i-graganskiot-sektor-zaedno-ke-se-borat-protiv-kriminalot-i-korupsijata/>.

Mbikëqyrja Civile e Sektorit të Sigurisë/Inteligjencës

Më 1 korrik, Kryeministri njoftoi se Agjencia e Inteligjencës dhe Agjencia e Sigurisë Kombëtare do të bashkoheshin në një entitet, një proces që pritet të zgjasë disa muaj. Bashkimi pason reformat e mëparshme në shërbimet e sigurisë të Maqedonisë së Veriut pas skandalit të përgjimeve të vitit 2019. Duke njoftuar këtë, Kryeministri deklaroi se bashkimi synon të forcojë bashkëpunimin në luftën kundër terrorizmit dhe krimit të organizuar, duke ndjekur standardet e NATO-s dhe BE-së. Plani është pjesë e agjendës së Qeverisë, me objekt të ri që do të ndërtohet për Agjencinë.³⁰

Pas një ndryshimi të kryesisë në fund të qershorit, i cili shkaktoi konfrontime politike midis qeverisë së re dhe opozitës, u ngritën pyetje mbi emërimin e zëvendësdrejtoreshës të re të Agjencisë së Inteligjencës në fillim të korrikut. Kritikët argumentuan se asaj i mungon dhjetë vjet përvojë të kërkuar ligjërish në fushat përkatëse, me vetëm shtatë vjet në Agjenci dhe role të mëparshme që nuk lidhen me sigurinë. Megjithatë, Zyra e Presidentes mbrojti kualifikimet e saj, duke përmendur rolet akademike në lëndët e lidhura me sigurinë dhe përvojën shtesë në sigurinë kibernetike.³¹ Në përgjigje të këtyre shqetësimeve, KSHPK hapi një lëndë më 10 korrik për të hetuar nëse e emëruara i plotëson kërkesat ligjore.³² Kritikën për këtë emërim erdhën nga ish-ministrat e mbrojtjes dhe deputetët aktualë të LSDM-së, të cilët gjithashtu akuzuan qeverinë për emërim të paligjshme në Ministrinë e Brendshme dhe paralajmëruan kundër vendosjes së besnikëve të partisë në Agjencinë e Sigurisë Kombëtare dhe inteligjencën ushtarake.³³

Më 18 korrik, Kryetari i Kuvendit u takua me përfaqësues nga zyra e Shkupit e Qendrës së Gjenevës për Qeverisje të Sektorit të Sigurisë (DCAF) për të diskutuar partneritetin e tyre strategjik mbi reformat parlamentare dhe të inteligjencës së sigurisë. Ata shqyrtuan progresin e projektit, duke përfshirë gati përfundimin e një 'dhome të mbrojtur' për diskutime të sigurta, dhe theksuan nevojën për të formuar një Këshill të Mbikëqyrjes Civile për mbikëqyrje efektive.³⁴

Nga fundi i shtatorit, një grup punonjësish të Agjencisë së Inteligjencës u dërguan një letër anonime mediave, ambasadave të huaja dhe Zyrës së Presidentit duke pretenduar se Kryeministri ka në plan të shfuqizojë Agjencitë e Sigurisë Kombëtare dhe të Inteligjencës për të krijuar një shërbim të kontrolluar politikisht. Ata akuzuan individët e lidhur me palët për hartimin e ligjit të ri dhe shprehën shqetësimin për erozionin e mbikëqyrjes profesionale. Letra i kërkonte Presidentes të ndërhynte dhe të parandalonte tradhtinë e pretenduar të sektorit të sigurisë së vendit.³⁵

30 'Shërbimet e inteligjencës do të bashkohen në një agjenci (Pazunavackite sluzbi ќе се спојуваат во една агенција)', DW, 1 korrik 2024, <https://www.dw.com/mk/nov-plan-na-vladata-mesto-dve-razunavacki-sluzbi-samo-edna-agencija/a-69527789>.

31 'A i plotëson Ivana Stojanovska kërkesat për Zëvendës Drejtoreshë të Agjencisë së Inteligjencës? (Дали Ивана Стојановска ги исполнува условите за заменик-директор на Агенцијата за разузнавање?)', 360 Stepeni, 4 korrik 2024, <https://360stepeni.mk/dali-ivana-stojanovska-gi-ispolnuva-uslovi-za-zamenik-direktor-na-agentsijata-za-razunavane/>.

32 'KSHPK hapi çështje për Zëvendës Drejtoreshën në Agjencinë e Inteligjencës dhe për Ish Zëvendës Ministrin në Ministrinë e Brendshme (ДККК оформи предмети за заменик-директорката во Агенцијата за разузнавање и за поранешниот заменик-министер во МВР)', 360 Stepeni, 10 korrik 2024, <https://360stepeni.mk/dkck-oformi-predmeti-za-zamenik-direktorkata-vo-agentsijata-za-razunavane-i-za-poranesniot-zamenik-minister-vo-mvr/>.

33 'Petrovska akuzohet për emërim të paligjshëm të zyrtarëve në Ministrinë e Brendshme dhe paralajmërohet kundër vendosjes së besnikëve partiak në Agjencinë e Sigurisë Kombëtare dhe inteligjencës ushtarake (Петровска обвини за незаконски распоредување службеници во МВР и предупреди за именување партиски послушници во АНБ и военото разузнавање)', 360 Stepeni, 10 korrik 2024, <https://360stepeni.mk/петровска-обвини-за-незаконски-распоредување-na-službenitsi-vo-mvr-i-predupredi-za-imenuvane-partiski-poslušnitsi-vo-anb-i-voenoto-razunavane/>.

34 'Takimi i Kryetarit Gashi me përfaqësuesit e zyrës së DCAF në Shkup (Средба на претседателот Гаши со претставници на канцеларијата на ДЦАФ во Скопје)', Faqja zyrtare e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 18 korrik 2024, <https://www.sobranie.mk/ns-newsarticle-sredba-na-pretседelot-gasi-so-pretstavnici-na-kancelarijata-na-dcaf-vo-skopje.nspx>.

35 'Inteligjenca paralajmëron tradhti: Kryeministri dëshiron të shfuqizojë ASK-në dhe AZ-në dhe të vendosë një person të afërt në një pozitë udhëheqëse (Разунавачите алармираат за предавство: Премиерот сака да ја укине АНБ и АР и да постави блиско лице на раководна позиција)', Sloboden Pечат, 23 shtator 2024, <https://www.slobodenpechat.mk/razunavachite-alarмираат-za-predavstvo-premierot-saka-da-ja-ukine-anb-i-ar-i-da-postavi-blisko-lice-na-rakovodna-pozicija/>.

Reforma e Administratës Publike

Në konferencën për shtyp të mbajtur më 30 korrik 2024, Ministri i Administratës Publike theksoi se ligjet për punonjësit e sektorit publik, nëpunësit administrativë dhe zhvillimin profesional dhe trajnimin e nëpunësve administrativë janë tërhequr nga procedura parlamentare për shkak të ndryshimeve të fundit në Ligjin për Organizimin dhe Punën e Organeve Administrative Shtetërore (LOPOASH).³⁶ Përveç ndryshimeve në LOPOASH, u theksua se debati i gjerë mbi këto ligje do të rihapet në mënyrë që të gjithë aktorët, përfshirë organizatat e shoqërisë civile, institucionet shtetërore, sindikatat, organizatat ndërkombëtare, përfaqësuesit e SIGMA dhe Komisionit Evropian, publiku ekspert dhe opozita të japin kontributin dhe mendimet e tyre.³⁷

Më 31 korrik 2024, Ministria e Administratës Publike (MAP), në bashkëpunim me Qendrën për Menaxhimin e Ndryshimeve (QMN), organizoi një diskutim publik mbi sfidat kryesore me të cilat përballen institucionet e sektorit publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Qëllimi i diskutimit ishte prezantimi i vizionit dhe angazhimeve të ardhshme të Qeverisë në fushën e qeverisjes së mirë dhe Reformës së Administratës Publike (RAP), si dhe hapja e një debati të gjerë me publikun profesional, përfaqësuesit nga institucionet dhe palët e tjera të interesuara për përmirësimin e rregullimit në Menaxhimin e Burimeve Njerëzore (MBN) në sektorin publik. U diskutuan propozim-ligjet e mëposhtme: Ligji për nëpunësit e sektorit publik, Ligji për nëpunësit administrativë dhe Ligji për zhvillimin profesional dhe trajnimin e nëpunësve administrativë.³⁸ Kjo ngjarje shënoi fillimin e fushatës 'Të gjithë së bashku për administratë publike profesionale dhe cilësore'.³⁹

Më 31 korrik 2024, Ministri për Transformimin Digjital hapi takimin e parë të grupit të punës për përgatitjen e Strategjisë Kombëtare për Sigurinë Kibernetike 2024–2028.⁴⁰ Strategjia e re do të përqendrohet në: (i) krijimin, mirëmbajtjen dhe përmirësimin e infrastrukturës të TIK-ut rezistente ndaj kërcënimeve kibernetike, (ii) identifikimin dhe përcaktimin e qartë të burimeve të kërcënimeve ndaj interesave kombëtare në drejtim të sigurisë kibernetike, si dhe zhvillimin e masave parandaluese dhe një plani të qartë reagimi, (iii) ndërtimin dhe përmirësimin e kapaciteteve të nevojshme për mbrojtje, (iv) promovimin e kulturës së sigurisë kibernetike midis qytetarëve, sektorit publik dhe privat, në drejtim të kuptimit të rreziqeve, praktikimin e higjienës kibernetike dhe parandalimin dhe trajtimin e kërcënimeve (v) forcimin e kapaciteteve kombëtare për parandalimin, hetimin dhe përgjigjen ndaj krimit kibernetik, (vi) përf forcimin e mbrojtjes së interesave kombëtare dhe zvogëlimin e rreziqeve aktuale dhe të ardhshme në hapësirën kibernetike, dhe (vii) promovimin e bashkëpunimit ndërkombëtar dhe shkëmbimin e informacionit.⁴¹

36 'Konferenca për shtypin e Ministrit të Administratës Publike (Прес-конференција на министерот за јавна администрација / Konferenca për shtypin e Ministrit të Administratës Publike)', Faqja zyrtare e Ministrisë së Administratës Publike, 30 korrik 2024, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/pres-konferencija-na-ministerot-za-javna-administracija--konferenca-per-shtypin-e-ministrit-te-administrates-publike.nspх>.

37 Ibid.

38 'Ministri i Administratës Publike, Goran Minçev, shënoi fillimin e fushatës "TË GJITHË SË BASHKU PËR ADMINISTRATË PUBLIKE PROFESIONALE DHE CILËSORE" (Министерот за јавна администрација, Горан Минчев, го означи почетокот на кампањата "СИТЕ ЗАЕДНО ЗА ПРОФЕСИОНАЛНА И КВАЛИТЕТНА ЈАВНА АДМИНИСТРАЦИЈА")', Faqja zyrtare e Ministrisë së Administratës Publike, 31 korrik 2024, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/ministerot-za-javna-administracija-goran-mincev-go-oznaci-pocetokot-na-kampanata-site-zaedno-za-profesionalna-i-kvalitetna-javna-administracija-%E2%80%9D.nspх>.

39 Ibid.

40 'Ministri Andonovski hapi takimin e parë të punës së grupit punues për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Siguri Kibernetike 2024-2028 (Министерот Андоновски го отвори првиот работен состанок на работната група за изработка на Националната стратегија за сајбер безбедност 2024-2028 година)', Faqja zyrtare e Ministrisë për Administratë Publike, 30 korrik 2024, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/ministerot-andonovski-go-otvori-prvot-raboten-sostanok-na-rabotnata-grupa-za-izrabotka-na-nacionalna-strategija-za-sajber-bezbednost--2024-2028-godina.nspх>.

41 Ibid.

Më 20 gusht 2024, Qeveria dorëzoi në Kuvend propozim-ligjin për përdorimin e të dhënave nga sektori publik.⁴² Të gjitha institucionet duhet të publikojnë të dhënat që krijojnë gjatë punës të tyre të përditshme dhe t'i bëjnë ato të qasshme për publikun.⁴³ Çdo institucion i sektorit publik duhet të sigurojë azhurnimin e rregullt të të dhënave të publikuara, funksionalitetin e faqes së internetit ku publikohen të dhënat dhe lidhjen aktive në katalogun qendror të të dhënave nga sektori publik në www.otvorenipodatoci.gov.mk.⁴⁴ Një person i caktuar i kontaktit do të jetë përgjegjës për rregullimet teknike dhe publikimin e të dhënave.⁴⁵

KSHPK ka paraqitur një iniciativë në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me Kalkulatorin e Balancuesit sepse beson se detyrimi që kandidatët për pozicione administrative të tregojnë kombësinë e tyre kur aplikojnë për një punë shkel të drejtën e garantuar me kushtetutë për shprehje të lirë të përkatësisë kombëtare.⁴⁸ Sipas KSHPK-së, përkatësia etnike është një ndjenjë personale, mund të jetë e ndryshueshme dhe nuk është kusht për punësim sipas Ligjit për punonjësit e sektorit publik ose Ligjit për nëpunësit administrativë. KSHPK-ja e sheh këtë kërkesë si parakusht përjashtues për pjesëmarrje në një shpallje publike, gjë që shkel parimin e bazuar në meritë.⁴⁹

Më 2 shtator 2024, Ministri për Transformimin Digjital prezantoi Planin Strategjik të Veprimit Katërvjeçar të ministrisë për partnerët dhe donatorët ndërkombëtarë. Ai theksoi vizionin e ministrisë për një shoqëri digjitale ku inovacioni fuqizon çdo qytetar, lufton korrupsionin, tërheq investime dhe nxit qëndrueshmërinë dhe barazinë. Ai theksoi se misioni kryesor në katër vitet e ardhshme do të jetë udhëheqja e transformimit digjital përmes politikave inovative, investimeve strategjike dhe partneriteteve bashkëpunuese.⁵¹

43 Ibid.

44 Ibid.

45 Ibid.

46 'Vend

përkasin të gjitha komuniteteve (Одлука за основање на Комисија на Собранието на Република Северна Македонија за следење на соодветната и правична застapеност на граѓаните кои припаѓаат на сите заедници), De Jure, 14 gusht 2024, [https://dejure.mk/zakon/odluka-za-osnovanje-na-komisija-na-sobranieto-na-republika-severna-makedonija-za-sledenje-na-soodvetnata-i-pravichna-zastapenost-na-gragjanite-koi-pri-plainCitation](https://dejure.mk/zakon/odluka-za-osnovanje-na-komisija-na-sobranieto-na-republika-severna-makedonija-za-sledenje-na-soodvetnata-i-pravichna-zastapenost-na-gragjanite-koi-pri-fililDe Jure], 14 August 2024, <a href=)”;"Decision on the Establishment of the Commission of the Assembly of the Republic of North Macedonia for Monitoring the Adequate and Fair Representation of Citizens Who Belong to All Communities (Одлука За основање На Комисија На Собранието На Република Северна Македонија За Следење На Соодветната и Правична Застапеност На Граѓаните Кои Припаѓаат На Сите Заедници

47 ‘Орозиќа акузон: “Marreveshje” e fishehtë midis VMRO-DPMNE-së dhe BDI-së, balancuesi i ekspozoi ato (Опозицијата обвинува: Таен „дил“ меѓу ВМРО-ДПМНЕ и ДУИ, балансерот ги разоткри), Sloboden Pecat, 14 gusht 2024, <https://www.slobodenpecat.mk/obvinuvanje-taen-dil-megju-vmro-dpmne-i-dui-balanserot-gi-razotkri/>.

48 “Balancersi” në seancën e nesërme të Gjykatës Kushtetuese - KSHPK është e shqetësuar se zbatimi çon në abuzim! (“Балансерот” утре на седница на уставниот суд – ДКСК смета дека примената води кон злоупотреби!), TV 21, 17 shtator 2024, <https://mk.tv21.tv/balanserot-utre-na-sednitsa-na-ustavniot-sud-dksk-smeta-deka-primenata-vodi-kon-zloupotrebi/>.

49 Ibid.

50 'Ministria e Administratës Publike me udhëzime se si të veprojë me «balancesin» (Министерството за јавна администрација со насоки како да постапува со „балансерот“), Kanal 5, 30 shtator 2024, <https://kanal5.com.mk/ministerstvoto-za-javna-administracija-so-nasoki-kako-da-postapuva-so-balanserot/a661727>.

51 'Ministri Andonovski prezantoi Planin Strategjik të Aktiviteteve të Ministrisë për Transformim Digital (Ministerot Andonovski go prezantirashë Strateshiot plan na aktivnosti na Ministerstvoto za digitalna transformacija)', Faqja zyrtare e Ministrisë për Administratë Publike, 23 shtator 2024, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/ministerot-andonovski-go-prezentirashë-strateshiot-plan-na-aktivnosti-na-ministerstvoto-za-digitalna-transformacija.nspx>.

Më 24 shtator 2024, Shkolla Rajonale e Administratës Publike (ReSPA) nisi modulën e katërt të Akademisë Rajonale mbi Procesin e Politikave të Bazuara në Evidencë, me fokus “Politikëbërja në Botën Digjitale”. Në të morën pjesë përfaqësues nga institucionet qeveritare dhe ekspertë të përfshirë në planifikimin dhe koordinimin e politikave në sektorin publik.⁵² Ministri i Administratës Publike theksoi rolin kritik të digjitalizimit në qeverisjen moderne dhe angazhimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për RAP, duke iu referuar zbatimit të suksesshëm të aplikacionit për monitorimin e Strategjisë së RAP të zhvilluar me mbështetjen e ReSPA.⁵³

52 ‘Ministri i Administratës Publike, Goran Minçev, iu drejtua modulit të katërt të Shkollës Rajonale për Administratë Publike - ReSPA, me fokus në «Krijimin e politikës në botën digjitale» (Министерот за јавна администрација Горан Минчев се обрати на четвртиот модул на Регионалната школа за јавна администрација - РеСПА, со фокус на „Креирање политики во дигиталниот свет“); Uebfaqja zyrtare e Ministrisë së Administratës Publike, 24 shtator 2024, <https://www.mioa.gov.mk/mk-MK/news/ministerot-za-javna-administracija-goran-mincev-se-obrati-na-cetvrtiot-modul-na-regionalnata-skola-za-javna-administracija---respa-so-fokus-na-kreirane-politiki-vo-digitalniot-svet.nspх>.

53 Ibid.

Kapitulli 23



Funksionimi i Gjyqësorit

Dokumente strategjike

Gjatë kësaj periudhe raportuese nuk ka pasur zhvillime të dukshme në dokumentet strategjike.

Organet e menaxhimit

Gjatë periudhës raportuese, Këshilli Gjyqësor ndërpreu mandatin e anëtarit të zgjedhur nga radhët e gjyqtarëve, i cili gjithashtu kishte shërbyer si kryetar i zgjedhur në mënyrë të paligjshme një vit më parë me mbarimin e mandatit të tij.⁵⁴ Përveç kësaj, Këshilli emëroi një anëtar të ri - kandidatin e vetëm të regjistruar - nga radhët e gjyqtarëve që përfaqësojnë komunitetet me popullsi që përbëjnë më pak se 20% të popullsisë së Maqedonisë së Veriut.⁵⁵

Përfundimi i mandatit të një anëtari ka ndodhur edhe brenda Këshillit të Prokurorëve Publikë në korrik.⁵⁶ Në të njëjtin muaj, Këshilli zgjodhi një anëtar të ri, kandidatin e vetëm të regjistruar, nga radhët e prokurorëve publikë brenda juridiksionit të Prokurorisë së Lartë Publike në Manastir.⁵⁷ Po atë muaj, pas dorëheqjes së nënkryetarit, i cili, në gusht, u deklarua fajtor për pranimin e rryshfetit dhe mori një dënim të pezulluar me një vit burg, Këshilli zgjodhi një nënkryetar të ri nga prokurorët, bazuar në një rekomandim nga kryetari i Këshillit.⁵⁸ Në shtator, Këshilli caktoi një nga anëtarët e tij në Këshillin Etik të Prokurorëve Publikë dhe një tjetër në Trupin Kombëtar Koordinues për Zbatimin e Konventës së Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftimin e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje.⁵⁹

Pavarësia dhe paanshmëria

Më 12 korrik, Gjykata Supreme e Republikës së Maqedonisë së Veriut, gjatë Sesionit të Përgjithshëm, miratoi një qëndrim parimor në lidhje me akreditimin e mediave për lëndët civile me interes të rëndësishëm publik. Ky vendim përputhet me parimet kushtetuese dhe ligjore të transparencës dhe publicitetit, si dhe me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut.⁶⁰ Me anë të kësaj mase, Gjykata Supreme riafirmoi angazhimin e saj për një gjyqësor të hapur dhe transparent.

Pas thirrjes publike të Kryeministrit për propozime për reformimin e gjyqësorit, u zhvillua një takim më 20 gusht, i iniciuar nga Kryetari i Këshillit Gjyqësor.⁶¹ Ndërsa asnjë propozim specifik nuk u zbulua për publikun pas takimit, Kryeministri përsëriti qëndrimin e tij për shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.⁶² Megjithatë, ai la të hapur mundësinë e shqyrtimit të propozimeve alternative për të rikthyer besimin e publikut në këto institucione në mes të diskursit publik në vazhdim.⁶³

54 'Njoftim nga Seanca e 498-të e Këshillit Gjyqësor të RMV - 10.09.2024 (Соопштение од 498-та седница на Судскиот совет на РСМ - 10.09.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://bit.ly/4eDm79A>.

55 'Njoftim (Соопштение)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 5 shtator 2024, <https://bit.ly/3BGf29A>.

56 'Procesverbal i seancës së 106-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë (Записник од 106 седница на Советот на јавни обвинители)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 17 korrik 2024, <https://sjorm.gov.mk/zapisnik-od-106-sednica-na-sjorm/>.

57 'Shpallja e rezultateve përfundimtare të zgjedhjeve për anëtar të Këshillit të prokurorëve publikë nga zona e Prokurorisë së Lartë Publike të Manastirit, e mbajtur më 29.07.2024 (Соопштение за конечни резултати од спроведени избори за член на Советот на јавните обвинители од подрачјето на Вишото јавно обвинителство Битола, одржани на 29.07.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit të prokurorëve publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, <https://sjorm.gov.mk/soopshtenie-za-javnost-za-odrzhana-sednica-na-den-20-09-2024-godina/>.

58 'Procesverbal i seancës së 106-të të Këshillit të Prokurorëve Publikë (Записник од 106 седница на Советот на јавни обвинители)'.

59 'Njoftim publik për seancën e mbajtur më 20 shtator 2024 (Соопштение за јавност за одржана седница на ден 20.09.2024 година)', Faqja zyrtare e Këshillit të Prokurorëve Publikë të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2024, <https://bit.ly/3BKmkcs>.

60 'Gjykata Supreme krijoi një qëndrim parimor për akreditimin e mediave në lëndët civile me interes publik (Врховниот суд утврди начелен став за акредитација за медиумите во граѓанските предмети од јавен интерес)', Faqja zyrtare e Gjykatës Supreme të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 12 korrik 2024, <https://bit.ly/3BKmkcs>.

61 'Takim pune (Работна Средба)', Faqja zyrtare e Këshillit Gjyqësor të Republikës së Maqedonisë së Veriut, 22 gusht 2024, <https://bit.ly/4ha6Xuk>.

62 'Qeveria mban qëndrimin e saj për nevojën e reformave radikale në gjyqësor, tha Mickoski pas takimit me Dameva (Владата останува на ставот за потребата од коренiti reformi во правосудството, порача Мицкоски по средбата со Дамева)', AIM- Agjencia Informative Mediatike, <https://bit.ly/3zZMpE2>.

63 'Mickoski: Programi i VMRO-së parashikon shpërbërjen e Këshillit Gjyqësor, por ne jemi të hapur për sugjerime (Мицкоски: Програмата на ВМРО предвидува распуштање на Судскиот совет, но отворени сме за предлози)', TV ALFA, 21 gusht 2024, <https://alsat.mk/mk/mitskoski-programata-na-vmro-predviduva-raspushtane-na-sudskiot-sovet-no-otvoreni-sme-za-predlozi/>.

Enti Shtetëror i Revizionit (ESHR), në raportin e tij për pajtueshmërinë e operacioneve financiare të Gjykatës Themelore Civile Shkup, botuar në gusht, identifikoi çështje të rëndësishme në lidhje me menaxhimin financiar të gjyqësorit në Maqedoninë e Veriut.⁶⁴ Një nga shqetësimet kryesore të ngritura është zvogëlimi i vazhdueshëm i fondeve të alokuara për gjyqësorin, i cili bie në kundërshtim të drejtpërdrejtë me Ligjin për Buxhetin Gjyqësor, duke ndaluar shkurtimet e buxhetit gjatë ribalancimit.⁶⁵ Pavarësisht këtyre mbrojtjeve ligjore, një reduktim prej 89,906,000 denarë u miratua në dhjetor 2023. Raporti gjithashtu vuri në dukje mospërputhjet në menaxhimin e depozitave gjyqësore, mungesën e rregulloreve të qarta për përcaktimin e pagave të personelit teknik dhe ndihmës të gjykatave, dhe mospërputhjet në dispozitat ligjore që rregullojnë pronësinë e depozitave të vjetëruara gjyqësore.⁶⁶ Për më tepër, Gjykata Themelore Civile Shkup përballat me vështirësi financiare të pazgjidhura, duke përfshirë dokumentacionin joadekuat të vlerës së hapësirave të saj dhe mosmarrëveshjet e vazhdueshme ligjore në lidhje me kërkesat e punonjësve për pagesa të prapambetura dhe rregullime të pagave, duke rezultuar në detyrime të rëndësishme financiare.⁶⁷

Në përgjigje të kritikave të përsëritura nga publiku profesional në lidhje me transparencën e tij, Këshilli i Prokurorëve Publikë filloi fazën përfundimtare të zhvillimit të një faqeje të re të internetit në shtator. Faqja e internetit pritet të jetë funksionale deri në fillim të tetorit.⁶⁸

Llogaridhënia

Në korrik, Kryetari i Këshillit Gjyqësor informoi Kryetarin e Kuvendit se një gjyqtare e Gjykatës Kushtetuese, e cila kishte shërbyer si Kryetare e Gjykatës deri në qershor, kishte arritur moshën e pensionit, duke humbur kështu statusin e gjyqtare aktive, që është kërkesë për anëtarësim në Gjykatën Kushtetuese.⁶⁹ Në shkresën e tij, Këshilli Gjyqësor barazoi statusin e anëtarëve të tij me atë të gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, duke iu referuar dispozitave përkatëse të Kushtetutës dhe Ligjit për Këshillin Gjyqësor.⁷⁰ Si rezultat, Këshilli informoi Kuvendin për të shqyrtuar veprimet e mundshme të mëtejshme në lidhje me gjyqtaren. Gjithashtu, Këshilli Gjyqësor propozoi dy gjyqtarë si anëtarë të rinj të Gjykatës Kushtetuese.⁷¹ Gjykata Kushtetuese nuk ka komentuar çështjen, duke cituar vetëm nenin 111, pika 4 të Kushtetutës. Për më tepër, Këshilli Gjyqësor nuk dha shpjegime se pse njoftimi ishte dërguar në këtë kohë, duke qenë se gjyqtarja kishte përmbushur kushtet e daljes në pension dy vjet më parë, më 30 qershor 2022.⁷²

